

From: Besnik Dervishi <besnik.dervishi@idp.al>
Sent: 14 September 2015 15:13
To: 'ligjet@parlament.al'
Subject: Dërgohet mendim mbi projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7961, dt. 12.07.1995 "Kodi i Punës i RSH", i ndryshuar.

Drejtuar: KOMISIONIT PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE TË DREJTAT E NJERIUT, KUVENDI I SHQIPËRISË.

Në përgjigje të e-mail tuaj, projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7961, dt. 12.07.1995 "Kodi i Punës i RSH", vlerësohet i hartuar konform kërkesave të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.

Ndërkohë, do të vlerësonim përshtatjen e projektligjit me sugjerimet e mëposhtme.

Pas nenit 15 të Projektligjit, shtohet një nen me këtë përmbajtje:

Pas nenit 32, shtohet neni 32/1, me këtë përmbajtje:

Neni 32/1

Detyrimi për mbrojtjen e të dhënave personale

1. Punëdhënësi është i detyruar të marrë masa sigurie për mbrojtjen e të dhënave personale të punonjësve që përpunohen në fushën e marrëdhënies së punës, duke i kushtuar vëmendje të dhënave sensitive në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.
2. Punëdhënësi që vihet në dijeni me të dhënat e përpunuara të punëmarrësit, gjatë ushtrimit të funksionit të tij, detyrohet të ruajë konfidencialitetin dhe besueshmërinë. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj. Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit zgjat pambarimisht.
3. Të dhënat e përpunuara në dosjen e punëmarrësit, pas përfundimit të marrëdhënies së punës, sipas përcaktimeve të pikës 2 të nenit 146 të këtij kodi ruhen nga punëdhënësi për një periudhë 6 – mujore nga data e marrjes së njoftimit nga punëdhënësi.
4. Në çdo rast tjetër, të dhënat personale të përpunuara në dosjen e punëmarrësit ruhen deri në përfundim të marrëdhënies së punës. Përpunimi i të dhënave në tejkallim të këtij afati bëhet me marrjen e pëlqimit të punëmarrësit.

Neni i propozuar nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është në përputhje me nenin 35 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe nenet 6, 16 dhe 17 të Direktivës 95/46/EC të Këshillit Evropian dhe Parlamentit Evropian, me Konventën 108 të Këshillit të Evropës “Për mbrojtjen e individëve nga Përpunimi Automatik i të Dhënave Personale”, ratifikuar me Ligjin nr.9288, datë 7.10.2004 si dhe me ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.

Kjo dispozitë është në përputhje edhe me rekomandimin e datës 3 Qershor 2014 të Këshillit të Evropës “Mbi mbrojtjen e të dhënave personale të përdorura për qëllime punësimi”.

Ky nen rregullon në mënyrë të përgjithshme parandalimin e shkeljeve të rregullave të përpunimit të të dhënave personale të punëmarrësve nga ana e punëdhënësit duke i vendosur këtij të fundit detyrimin e marrjes së masave të sigurisë për të garantuar në këtë mënyrë të drejtat dhe liritë e individëve, dhe në veçanti të drejtën e ruajtjes së jetës private.

Rëndësi të veçantë duhet ti jepet detyrimit lidhur me përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave sensitive. Me “të dhëna sensitive” sjellim në vëmendje të dhënat që lidhen me shëndetin, kartelat mjekësore të punëmarrësve, fushën e sigurimit shëndetësor, etj, të cilat rregullohen me akte të veçanta në zbatim të legjislacionit përkatës.


Shtimi i kësaj dispozite vjen si risi për këtë Kod duke rritur integritetin e punëmarrësve dhe shtuar detyrimet e punëdhënësve në përputhje me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Besnik Dervishi

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

www.idp.al



**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE**

Informacioni i transmetuar në këtë mesazh ka përmbajtje konfidenciale. Është i ndaluar printimi apo shpërndarja nga persona dhe subjekte të ndryshëm prej marrësit të destinuar të këtij mesazhi. Nëse merrni gabimisht këtë mesazh, fshini nga kompjuteri juaj çdo material lidhur me të.